



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 18 Prot.

Tiranë, më 13.01.2017

V E N D I M

Nr. 1, datë 13.01.2017

“Për verifikimin e zbatimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 100, datë 13.09.2016 dhe verifikimin e ligshmërisë së veprimeve administrative në fushën e administrimit të shërbimit civil të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të kryera prej datës 20.05.2016 e në vazhdim”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenit 34 e vijues të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 100, datë 13.09.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligshmërisë së veprimeve administrative gjatë administrimit të shërbimit civil, të kryera nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, prej datës 20.05.2016 (data e përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit) e në vazhdim.

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 100, datë 13.09.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.
2. Verifikimin e ligshmërisë së veprimeve administrative gjatë administrimit të shërbimit civil, të kryera nga ky institucion, prej datës 20.05.2016, (data e përfundimit të mbledhjes

së dokumentacionit nga ana e Komisionerit) e në vazhdim sipas objektit dhe aneksit që përmban Programi i Verifikimit, i cili është pjesë e këtij vendimi.

3. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:
 - **Altin Shumeli**, Drejtues Teknik
 - **Irma Vani** Inspektore në Drejtorinë e Mbikëqyrjes
 - **Matilda Idrizaj** Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit
4. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt, në datën 17.01.2017 dhe do të vijojë me grumbullimin e të dhënave deri në datën 20.01.2017.
5. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e relacionit, i cili pas konsultimit me Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, brenda datës **31.01.2017**, do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, dhe më tej, deri më datë **03.02.2017**, do të hartohet vendimi përfundimtar për përmbylljen e tij.
6. Vendimi përfundimtar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrativ (*verifikimit*) do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Njesisë Përgjegjëse (*Departamentit të Administratës Publike*) dhe Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA